

VENDIM
Nr. 858, datë 7.12.2016

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE, PËR DISA
NDËRHYRJE EMERGJENTE PËR INFRASTRUKTURËN E MBROJTJES NGA
PËRMBYTJET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në programin buxhetor 04240 “Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujërave”, shtohet fondi i investimeve prej 141 840 000 (njëqind e dyzet e një milionë e tetëqind e dyzet mijë) lekësh, për ndërhyrje emergjente në infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytjet për objektet, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela e objekteve të infrastrukturës të mbrojtjes nga përmbytja.

Nr.	Emertimi i objektit	Vlera në lekë	Institucioni përgjegjës
	Totali	141 840 000	
	Argjinatura e lumit Kir	20 000 000	Bordi Rajonal i Kullimit Lezhe
	Argjinatura e lumit Mat Tale	17 600 000	Bordi Rajonal i Kullimit Lezhe
	Argjinatura e lumit Drin Spathar Shkoder	7 000 000	Bordi Rajonal i Kullimit Lezhe
	Argjinatura e lumit Mat (krahu i djathtë i rjedhjes superstarda Lezhe-Tirane	10 000 000	Bordi Rajonal i Kullimit Lezhe
	Riparim ne argjinaturen e Gjorices (e poshtme + e siperme)	30 576 000	Bordi Rajonal i Kullimit Durres
	Riparimi i mbrojtjes lumore Drin i Zi, Podgorce	8 164 000	Bordi Rajonal i Kullimit Durres
	Mbrojtje brigjesh ne Zallin Okshtun prane argjinatures fshati Gjorice	48 500 000	Bordi Rajonal i Kullimit Durres

